



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 957/4 Prot.

Tiranë, më 18/04 /2023

VENDIM

Nr. 09, datë 18.04.2023

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTIT KËRKIMOR-SHKENCOR, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË
TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT, ME NËNFUSHA
INXHINIERI INFORMATIKE DHE NËNFUSHA TELEKOMUNIKACION DHE
INXHINIERI INFORMACIONI, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, VKM Nr. 185, datë 25.03.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018", Udhëzimeve të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 dhe Nr. 7, datë 31.03.2021, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.04.2023,

VENDOSI:

Të miratojë projektin kërkimor-shkencor me titull "Projektimi i metodave të reja të përmirësimit të efektivitetit spektrale dhe energjitike të rrjetave celular dhe Wireless, propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, me nënfusha Inxhinieri Informatike dhe nënfusha Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni, të riorganizuar, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

